



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	28.10.2020	viti god year	0
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prof Nr Prof Prof No	Shtori - Faqja Appendix	Sasia Kolicina Quantity
MBIKËQYRËS	2315/2020		1/4



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr.255/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti, anëtarë dhe Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.255/2020 të datës 31.08.2020, të parashtruar nga [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati Jeton Osmani, me adresë RR.“UÇK” Nr.24/1 në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Financave-Thesari i Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A. Nr. 255/2020, e datës 31.08.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. SHFUQIZOHET Akt Emërimi i datës 07.07.2020, i lëshuar për ankuesen [redacted]

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data pranimit të këtij vendimi, të zbatoj këtë vendim duke bërë lëshimin e Akt Emërimit për ankuesen [redacted] në pajtim me dispozitat ligjore.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosi e Ankesave.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] ka themeluar marrëdhënie të punës tek punëdhënësi Ministria e Financave-Thesari i Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 10.04.2018, në pozitën “Zyrtar në Njësinë e Borxheve-Zyra e Përparme” më periudhë provuese nga data 09.04.2018 deri 09.04.2019. Bazuar në vlerësimin e udhëheqëses së drejtpërdrejt të datës 05.03.2019 për



mos konfirmim të periudhës provuese, Ministria e Financave-Thesari i Kosovë me vendim Nr. 09/2018 të datës 18.03.2019 i ka ndërprerë marrëdhënien e punës ankueses [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] Pas shterimit të së drejtës së ankesës në procedurë administrative, ankuesja ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata me aktgjykim Nr. A. 1271/2019 të datës 11.10.2020, ka pranuar kërkesëpadinë si të bazuar, ka anuluar vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës Nr. 09/2018 dhe ka obliguar Ministrinë e Financave që ta kthej ankuesen në vendin e punës “zyrtare në njësinë e borxheve.”

Me datë 23.01.2020 ankuesja paraqet propozim për përmbarim të aktgjykimit Nr. A. 1271/2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Divizioni Administrativ, ku kjo e fundit me vendimin e saj Np .Nr. 125/20 të datës 24.02.2020 pjesërisht ka pranuar kërkesën e kreditores-ankueses duke detyruar Thesarin e Kosovës që ankuesen ta kthej në vendin e punës ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin A. 1271/2019.

Ministria e Financave-Thesari i Kosovës me datë 07.07.2020 bazuar në aktgjykimin A. Nr. 1271/2019 të datës 11.10.2020 dhe aktvendimin Np. Nr. 125/20 të datës 24.02.2020, ka lëshuar Akt Emërim për ankuesen, duke përcaktuar serish periudhë provuese nga data 06.03.2020 deri 06.03.2021. E pakënaqur me këtë Akt Emërim, ankuesja me datë 28.07.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2842, në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Thesarin e Kosovës.

Thesari i Kosovës përmes shkresës zyrtare të datës 06.08.2020 ka njoftuar ankuesen, se ankesa e saj nuk mund të trajtohet pasi që me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06 /L-114 për Zyratë Publikë, nuk parashihet shqyrtimi i ankesave nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Ankuesja [REDAKTUAR] me datë 28.08.2020, për mes Postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit-Thesari i Kosovës ka lëshuar Akt Emërimin në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Thesari i Kosovës, ndërsa ky fundit më datë 21.09.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë duke bashkangjitur shkresat ndërlidhur me lëndën.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, më datë 14.10.2020 ka nxjerr Vendimin VK.nr.1/2020 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.255/2020.

Kolegji për shqyrtim e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe juridike si dhe për vendosje meritore lidhur me ankesën, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 255/2020, e datës 31.08.2020, me numër protokolli 1658, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.09.2020; e-mail i datës 20.08.2020; e-mail i datës 06.08.2020; Njoftim lidhur me ankesën e datës 06.08.2020; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 28.07.2020; Akt Emërimi i datës 10.04.2018; Akt Emërimi i datës 06.03.2020; Aktgjykim A.nr.1271/2019 i datës 11.10.2019 nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Aktvendim Cp.nr.125/20 i datës 24.02.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë-

Departamenti i Përgjithshëm– Divizioni Civil; Njoftim për zbatimin e vendimit i datës 05.03.2020; Autorizim i datës 27.08.2020; Pliko e datës 27.08.2020 R9116555; Përgjigje ndaj ankesës e datës 16.09.2020; Propozim i datës 23.01.2020; Kërkesë për informim i datës 27.12.2019; Njoftim i datës 06.08.2020; Formulari për Vlerësimin e Punës Provuese i datës 05.03.2019; e-mail i datës 06.08.2020; e-mail i datës 16.09.2020; Njoftim i datës 05.10.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës e datës 14.10.2020; Vendim i datës 14.10.2020; e-mail i datës 16.10.2020; e-mail i datës 16.10.2020; e-mail i datës 23.10.2020; e-mail i datës 26.10.2020; Konkurs i datës 25.01.2018; Kërkesa për punësim e [REDAKTUAR] me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit *janë të bazuara, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimor të ankueses, e cila pretendon se Akt Emërimi i datës 07.07.2020 është në kundërshtim me legjislacionin e shërbyesve civil për arsye se punëdhënësi ka zbatuar dy herë punë provuese.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Akt Emërimi i datës 07.07.2020 me periudhë provuese nga data 06.03.2020, deri me datën 06.03.2021, është në kundërshtim me nenin 20, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se. “2.*Në përfundim të periudhës së punës provuese, eprori i drejtpërdrejtë në bazë të vlerësimit pozitiv të performancës, mbështetur në rezultatet në punë të nëpunësit civil, vendos konfirmimin ose jo të tij në atë pozitë pune,*” e ne rastin konkret ankuesja [REDAKTUAR] ka përfunduar periudhën provuese nga 09.04.2018 deri me datën 09.04.2019 sipas Akt Emërimit të datës 10.04.2018 dhe se Gjykata me aktgjykim e saj Nr. A. 1271/2019 të datës 11.10.2020 ka kthyer ankuesen në pozitën e saj si “zyrtare në Njësinë e borxheve”.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton së Ministria e Financave-Thesari i Kosovës, me lëshimin e Akt Emërimit të datës 07.07.2020 nuk ka zbatuar nenin 12, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbim Civilë dhe nenin 10 paragrafi 1 të Rregullores 07/2010, për Emërimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se pozitat e karrierës në shërbim civil janë pozita me afat të pa caktuar “.....*Pozitat e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale;.....Në përputhje me nenin 12, paragrafi 1 të ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, pozitat në shërbimin civil të Kosovës janë pozita e karrierës të cilat me afat të pacaktuar*”, e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjënë se Ministria e Financave-Thesari i Kosovës ka dështuar në zbatimin e së drejtës material dhe është dashur që ankueses ti lëshoj Akt Emërim të përhershëm.

Kolegji për shqyrtim të ankesave, për vendosje mori parasysh edhe dispozitat e nenit 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punë Provuese të Shërbyesve Civilë, sipas të cilit puna provuese është në kohëzgjatje vetëm prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, dhe se në asnjë rrethanë nuk parasheh zgjatje të periudhës provuese përveç rasteve të pushimit lehonisë, pushimit mjekësorë, shërbimit ushtarak dhe rrethanave tjera, ku periudha provuese zgjatet për aq kohë sa është ndërprerë, por as sesi përtej periudhës 12 muaj.

Bazuar në nenin 21 paragrafi 2 të Ligji Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ministria e Financave-Thesari i Kosovës duhet të zbatoj ketë vendim brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga data e pranimit të tij, e në rast të mos zbatimit, Këshilli do të veprojë në pajtim me nenin 23 dhe 24 të Ligjit Nr./L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në atë që u tha si me lart, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 255/2020



Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Çlirim Zeka

procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit Juridik të ankueses Avokat Jeton Osmani;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës
- Menaxheres së Personelit të Thesarit të Kosovës
- Arkivit të KPMSHCK-së

